



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:585/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

I. Nuk ri/akreditohen programet e studimit në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë.

1. *Edukim Fillor, BA 240 ECTS (R);*
2. *Mësimdhënia e Gjuhës së Huaj Angleze, MA 60 (A);*
3. *Informatikë Inxhinierike, BSc 180 ECTS (A)*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I

Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Edukim Fillor, BA 240 ECTS (R)</i>	Zamira Gashi Shatri Edita Haxhijaha Ruzhdi Kadrija Venera Vala Kendusi
2.	<i>Mësimdhënia e Gjuhës së Huaj Angleze, MA 60 (A)</i>	Laura Naka
3.	<i>Informatikë Inxhinierike, BSc 180</i>	Drilon Bunjaku Agon Kokaj Ilmi Hoxha

Faqe 1 nga 3

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këto programe dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Edukim Fillor, BA 240 ECTS (R) vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 04.02.2025 me këtë përbërje: *Melita Kovacevic, Miklos Hoffmann dhe Elisa Knief.*

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht përmbush një (1) fushë të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Nuk i përmbushë kriteret, një (1) fushë të standardeve të akreditimit;

2. Për programin e studimit; Mësimdhënia e Gjuhës së Huaj Angleze, MA 60 (A) vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 05.02.2025 me këtë përbërje: *Melita Kovacevic, Tanja Gradecak dhe Elisa Knief.*

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Nuk i përmbushë kriteret, një (1) fushë të standardeve të akreditimit;

3. Për programin e studimit; Informatike Inxhinierike, BSc 180 vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 05.02.2025 me këtë përbërje: *Seifedine Kadry, Miklos Hoffmann, Kruno Milicevic dhe Matej Drobnic.*

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht përmbush dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të akreditimit për programet e lartë përmendura të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale nga ekspertët, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,